



Për një të Ardhme të Qëndrueshme

Mbështetje Institucionale për Zonat e Mbrojtura në Shqipëri

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë © IUCN/T.Pezold

Zonat e Zbatimit të Projektit: Peisazhi i Mbrojtur i Lumit Buna dhe Territoreve Ligatinore përreth tij (PM) dhe Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PK)


Zbatuar nga: Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) në partneritet me Ministrinë e Mjedisit (MM) dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Financuar nga: Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)

Bashkëpunorë: Dy Anëtarët e IUCN-së në Shqipëri, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)

Faqja e internetit e projektit: www.iucn.org/projectalbania

Broshura "Për një të ardhme të qëndrueshme" <http://bit.ly/2j9Pr19>



Arritjet afatgjata

- Kontriboi në krijimin e një kuadri të ri kombëtar institucional për zonat e mbrojtura,
- Iniciu ndryshime legjislative në vend, nëpërmjet krijimit të një instrumenti teknik që garanton një format uniform dhe gjithëpërfshirës të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura në vend, i miratuar formalisht nga qeveria përmes një Dekreti ministrior mbi përmbajtjen standarte të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri,
- Forcoi politikatat kombëtare për zonat e mbrojtura duke integruar përjasjen sistematike të proceseve të planifikimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura
- Involvoi për herë të parë në një shkallë të gjerë aktorët lokal në proceset konsultuese për planifikimin e menaxhimit bazuar në zonë, duke marrë në konsideratë njohuritë e tyre,
- Përmirësoi planifikimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri dhe mbështeti zhvillimin e mëtejshëm të tyre duke forcuar potencialin e tyre për të gjeneruar të ardhura pa kompromentuar ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

Veprimtari bazuar në vend

- Plane menaxhimi për Peisazhin e Mbrojtur të Lumit Buna dhe Territoreve ligatinore përreth tij (PM) dhe Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë (PK) i përgatitur sipas Udhëzimeve për Planifikimin e Menaxhimit të IUCN WCPA (Komisioni Botëror mbi Zonat e Mbrojtura),
- Hartat e vegjetacionit dhe habitatit të ripunuara 1:50.000 për të dy zonat pilote janë publikuar,
- Instrumentat dhe metodologjitë që udhëheqin planifikimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura,
- Rrjeti kombëtar i Biodiversitetit në Shqipëri (BioNNA) u ngrit për të siguruar grumbullimin e të dhënave të biodiversitetit sipas protokolleve standarte, ruajtjen e tyre si dhe bërjen të vlefshme për komunitetin shkencor dhe publikun e interesuar,
- APP i AKZM i hartuar për promovimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri, me të dhënat për të dy zonat pilote të projektit.



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë © IUCN/T.Pezold



Peisazhi i Mbrojtur i Lumit Buna © IUCN/T.Pezold

Veprimtari bazuar në vend

- 47 persona të trajnuar mbi monitorimin e florës dhe faunës, ujërave dhe analizën e aspekteve socio-ekonomike në të dy zonat e mbrojtura,
- 25 orë trajnimi për 13 persona nga Drejtoritë e Shërbimi Pyjor Qarku Librazhd dhe Shkoder dhe Ministria e Mjedisit mbi teknikat e planifikimit të menaxhimit,
- Nje udhëtim studimor dy ditor në Parkun Kombëtar të Pelister-it, FYRO Macedonia u organizua për 14 persona pjesë të stafit të PK Shebenik-Jabllanicë,
- Gjashtë Rojeve mjedisore ju mundësua një kurs i gjuhës Angleze,
- Eksperti GIS i NAPA u trajnuar për përdorimin e bazave të dhënave.

Përmirësimi i infrastrukturës

- Peisazhi i Mbrojtur i Lumit Buna dhe Territoreve Ligatinore përrreth tij
 - » Pastrimi i 2000m² në plazhin e Velipojës
 - » Ndërtimi i kullës prej druri për vëzhgimin e zogjve, 12m e lartë dhe një platform druri prej 15m² mbi grykëderdhjen e Bunës
 - » Rikonstruksioni i godinës dhe hapja e Qendrës së Vizitorëve në Velipojë
 - » Pastrimi dhe markimi i 7 shtigjeve për bicikleta, 122 km të gjatë
- Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë
 - » Rikonstruksion ndërtese dhe hapja e Qendrës së Vizitorëve në Fushë Stude
 - » Rikonstruksioni i zyrave në Administratën e Zonave të Mbrojtura në Librazhd
 - » Pastrimi dhe markimi i 13 shtigjeve për bicikleta dhe për marshim (245 km gjatësi totale)

Rritja e Ndërgjegjësimit

- Gjashtë numra të gazetës së projektit “Shqipëri e Avancuar”
- ‘Thesari ynë i fshehur’, një dokumentar 45’ i gjatë,
- Bashkëorganizimi i Festivalit të Filmit Mjedisor të Shqipërisë në vitin 2013 dhe 2014,
- Mbështetje për festimin e katër festave lokale në PK Shebenik-Jabllanicë,
- Dy fushata ndërgjegjësuere me përfshirjen e gjashtë shkollave përreth PM të Lumit Buna dhe gjashtë shkolla në Shebenik, me një total 180 dhe 150 nxënësish të involvuar,
- Fushatë ndërgjegjësuere në 20 fshatra në PK Shebenik-Jabllanicë me qëllim rritjen e njohurive lokale mbi parkun dhe vlerat e tij,
- Garë me bicikleta malore në Fushë Studë në 2016, për të promovuar PK Shebenik-Jabllanicë si një destinacion ekoturizmi.

Paisje

Sipas nevojave të identifikuar nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Ministria e Mjedisit, janë sgruruar materiale dhe paisje për punën në terren:

- Monitorimi ekologjik I dy zonave (GPS, dylbi, kamera kurth, instrumenta për analizimin e ujit, kompjutera, etj.)
- Patrullimi (maknë, sete kampimi, etj.)
- Rritje e Ndërgjegjësimit (projector, materiale promocionale, etj.)